



Pranuar / Dorezuar Punisheno/Prodato Received/Delivered	31-03-2023	3	viti god year
Organ /Institucia Org /Instit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlopja Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHK	3242/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.318/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi -Zyrtar i lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.318/2023 të datës 06.02.2023 të parashtruar nga ankuesit dhe i, të cilët me autorizim i përfaqëson me adresë: Kruga "Agim Ramadani", H-345, K-1, Nr.1, Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë Disiplinore" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 31.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.318/2023 e datës 06.02.2023 e parashtruar nga ankuesit

II. MBETEN në fuqi të tre (3) Vendimet me numër KD.nr.057/2023 të datës 23.01.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesit të cili sipas shkresave të lëndës janë të punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 06.02.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me Nr. Prot: 1412/2023, kundër Vendimeve me numër KD.nr.057/2023 të datës 23.01.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshill pretendojnë se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e aplikuara ligjore të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues si dhe ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankuesve si të bazuar, ndërsa të shfuqizojë Vendimet me numër KD.nr.057/2023 të datës 23.01.2023 të Komisionit Disiplinor, sikurse pretendojnë se të njëjti janë liruar padrejtësisht nga detyrat dhe përgjegjësit e punës në kuadër të Njesisë për Përcjelljen e të Burgosurve përmes e-mailit të datës 25.01.2023 nga udhëheqësi i kësaj njësie.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 06.03.2023 ka pranua nga Shërbimi Korrektues i Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokoll:2378/2023, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Më Vendimin me numër protokoll 2820/2023 të datës 20.03.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës A.nr.318/2023 të datës 06.02.2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.prot:1412/2022 të datës 06.02.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimet e datës 01.02.2023 të avokatit [i] [n] Vendimin me shifër KD.nr.057/2022 të datës 23.01.2023 i Komisionit Disiplinor për ankuesin [i] [n] Vendimin me shifër KD.nr.057/2022 të datës 23.01.2023 i Komisionit Disiplinor për ankuesin [i] [n]; Vendimin me shifër KD.nr.057/2022 të datës 23.01.2023 i Komisionit Disiplinor për ankuesin [i] [n]; Shkresa "urdhëresë nga gjykata" e datës 23.12.2022 P.nr.197/2022; Shkresa e datës 28.12.2022; E-mailin e datës 25.01.2023 dërguar nga M.A për I.H; Foto e veturës zyrtare me tabela 3Z-370-05; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.02.2023; Përgjigje në ankesë e datës 06.03.2023; E-mailin e datës 27.02.2023 dërguar nga M.S për Këshillin; Kontratën e punës së ankuesit [i] [n] të datës 15.07.2020; Kontratën e punës së ankuesit [i] [n] të datës 30.06.2018; Kontratën e punës së ankuesit [i] [n] të datës 30.06.2018; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar Korrektues; Raportin Përfundimtar të hetimeve i datës 04.01.2023; Vendimin e datës 29.12.2022 për themelimin e Komisionit Hetimor; Kërkesën e datës 30.12.2022; Procesverbalet nga intervistat e datës 29.12.2022; Vendimet e Komisionit Disiplinor të datës 29.12.2022; Shkresën "letër reshtim" të datës 29.12.2022; E-mailin e datës 29.12.2022 dërguar nga I.K për H.S; E-mailin e datës 29.12.2022 dërguar nga I.K për H.S me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 29.12.2022 dërguar nga S.D për M.A; E-mailin e datës 30.12.2022 dërguar nga M.A për H.S; Shkresat e quajtura "Forma e Pranim/Dorëzimit"; Formularin mbi dorëzimin e armës zyrtare; E-mailin e datës 27.03.2023 dhe 28.03.2023 dërguar Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore w SHKK për Këshillin.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa A.nr.342/2023 e datës 06.02.2023, e parashtruar nga ankuesit [i] [n] dhe [i] [n] është e pabazuar, sepse:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi Ruzhdi Restelica sipas kontratës së punës të datës 15.07.2020 ka të themeluar marrëdhënien e punës pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën "Zyrtar Korrektues-Qendra e Paraburgimit Lipjan", ankues.

sipas kontratës së punës të datës 30.06.2018 ka të themeluar marrëdhënien e punës pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën "Zyrtar Korrektues-Qendra e Paraburgimit Lipjan", ankuesi sipas kontratës së punës të datës 30.06.2018 ka të themeluar marrëdhënien e punës pranë Shërbimit Korrektues të Kosovës në pozitën "Zyrtar Korrektues-Qendra e Paraburgimit Lipjan", të cilëve Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes tre (3) vendimeve të cilat janë të së njëjtës datë 23.01.2023 dhe me të njëjtën shifër KD.nr.057/2022 u ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim i 20% të pagës për një (1) muaj" pasi që janë gjetur përgjegjës për shkelje të rënda të detyrave të punës të parashikuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ngase me datë 29.12.2022 të njëjtit ish-in të ngarkuar me transportimin dhe përcjelljen e të paraburgosurit G.K në seancën gjyqësore pranë Gjykatës themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë dhe ku pas mbajtjes së seancës i paraburgosuri kishte arritur të arratiset pavarësisht se ishte në të njëjtën veturë me ankuesit.

Kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore është bërë me datë 29.12.2022 nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesve, gjegjësisht Udhëheqësi i Njësisë për Përcjelljen e të Burgosurve dhe po ashtu Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues me datë 29.12.2022 kishte ngritur Komisionin Hetimor i cili me datë 04.01.2023 pas verifikimit të kamerave në rastin e ngjarjes, intervistimit të personave përgjegjës dhe ankuesve kishte hartuar raportin përfundimtar me numër:011 përmes të cilit kishte konstatuar se në rastin arratisjes së paraburgosurit pas mbajtjes së seancës gjyqësore të datës 29.12.2023, ankuesit kanë bërë lëshime sa i përket përmbushjeve të detyrave funksionale, veprime këto të cilat përbëjnë shkelje të rënda të detyrave të punës sikurse parashihet me nenin 58 pika 3 paragrafi 3.11 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës: "mos veprimi apo lënja pas dore e detyrës së tij si zyrtar korrektues", prandaj Komisioni Disiplinor bazuar në të gjeturat e theksuara si më sipër si dhe deklarimeve të ankuesve në seancat e procedurës disiplinore kishte ardhur në përfundimin se ankuesit kanë bërë lëshime në përmbushjen e detyrave të punës, ngase pas përfundimit të seancës gjyqësore dhe futjes në veturë i paraburgosuri ishte lënë i ulur vetëm në rreshtin e fundit të ulëseve të veturës duke e shfrytëzuar kështu mundësinë e thyerjes së xhamit të pasmë, ngase kishte distancë të mjaftueshme për ta kryer këtë veprim pasi që zyrtarët korrektues përveç vozitësit njëri kishte zgjedhur të ulet përpara ndërsa tjetri në rreshtin e dytë të ulëseve

Me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020 përkatësisht me nenin 4 paragrafi 1 është përcaktuar se: "Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë", nga rrjedh se me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, themelimi, ndryshimi, përfundimi i marrëdhënies së punës si dhe çdo e drejtë dhe detyrim nga marrëdhënia e punës për zyrtarët e shërbimit korrektues i nënshtrohet dispozitave të legjislacionit për nëpunësit civil dhe ligjeslacionit të veçantë, gjegjësisht Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik



ku përcaktohet se: "1.Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës" ndërlidhur me nenin 58 paragrafi 3 pika 3.11 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës ku përcaktohet se: "Përveç shkeljeve të parapara në Ligjin për Zyrtar Publikë, personeli i SHKK-së përgjigjen edhe për shkeljet disiplinore të veçanta. 3. Shkelje të rënda disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen: 3.11. mos veprimi apo lënja pas dore e detyrës së tij si zyrtar korrektues" si dhe ka analizuar nenin 21 të kontratës së punëve të ankuesve ku përcaktohet çështja respektimit të normave të sjelljes dhe disiplinës: "I punësuari informohet dhe obligohet t'iu përmbahet dhe t'i respektojë ligjet, aktet nënligjore, urdhrat dhe udhëzimet e përgjithshme dhe të veçanta të punëdhënësit, sidomos parimeve udhëzuese me të cilat udhëhiqet veprimtaria e punëdhënësit dhe Kodin e Etikës të Shërbimit Korrektues të Kosovës" dhe ka ardhur në përfundimin se ankuesit në rastin konkret kanë kryer shkelje të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës", andaj mbi këtë bazë Kolegji ka ardhur në parafundimin se Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesve ka vepruar drejtë pasi që të njëjti me rastin e shkelje së detyrave funksionale të punës ka konsumuar elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuara me nenin 45 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, prandaj ankesa e ankuesve është refuzuar si e pabazuar ndërsa Vendimit me numër KD.nr.057/2023 të datës 23.01.2023 për shqiptimin masave disiplinore ndaj ankuesve Bekim Zejnullahu, Lulzim Hetemi dhe Ruzhdi Restelica janë lënë në fuqi sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesëve se arratisja e të paraburgosurit ka ndodhur për shkak se vetura e caktuar me të cilën është bërë përcjelljen e të paraburgosurit për në seancën gjyqësore të datës 29.12.2022 ka qenë pa rrjeta mbrojtëse, ka gjetur se edhe në raportin e Komisionit Hetimor të datës 04.01.2023 është theksuar fakti se në rastet e tilla përcjellja e të paraburgosurve duhet të bëhet me automjete të cilat kanë rrjeta mbrojtëse, mirëpo ky fakt nuk i liron nga përgjegjësia disiplinore ankuesit, ngase të njëjtit nuk kanë ofruar asnjë provë relevante me të cilën do të dëshmonin se një çështje të tillë e kanë ngritur përpara se të ndodhte rasti i arratisjes së të paraburgosurit, shtuar faktin kësaj se i paraburgosuri ishte lënë ulur i vetëm në pjesën e pasme të automjetit sikurse u theksua edhe më lartë bazuar në raportin përfundimtar të datës 04.01.2023 Komisionit Hetimor. Po ashtu, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, pavarësisht që nuk është specifikuar në vendimin e Komisionit Disiplinor kjo rrethanë mund të jetë vlerësuar si lehtësuese ndaj ankuesëve pasi që masa e shqiptuar disiplinore ndaj ankuesëve është masa me e lehtë e shqiptuar në kuadër të masave tjera disiplinore që Komisioni Disiplinor mund t'i shqiptojë sipas kompetencës që ka në mbështetje të nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, prandaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.

Po ashtu lidhur me pretendimin ankimor të ankuesve se të njëjtit përmes emailit të datës 25.01.2023 dërguar nga Udhëheqësi i Njësitit për Përcjelljen e të Burgosurve ku theksohet fakti se ankuesit lirohen nga detyrat dhe përgjegjësitë në kuadër të kësaj njësie NJPB në QK Lipjan, Kolegji i Këshillit me datë 27.03.2023 përmes e-mailit zyrtar i është drejtuar Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës me kërkesën për sqarime shtesë se për çfarë veprimi institucional bëhet fjalë, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 28.03.2023 është përgjigjur si vijon: "Procedura e përzgjedhjes së zyrtarëve për tu angazhuar në punë për përcjelljen dhe transportin e të burgosurve është procedurë e brendshme e përzgjedhjes dhe nuk



nënkupton procedurë të rekrutimit pasi që zyrtarëve nuk ju ndryshon kontrata e punës dhe pozita, mirëpo vetëm caktohen në detyra për transportin e të burgosurve e që në rastin konkret për shkak të shkeljes së detyrave të punës dhe shqiptimit të masës disiplinore është vlerësuar e arsyeshme që të njëjtit të kthehen në vendin e punës sipas kontratës dhe ky veprim nuk duhet nënkuptuar si masë disiplinore, ... zyrtarët korrektues në fjalë në të ardhmen mund të vendosen përsëri në njësitin e transportit dhe mund të pajisen me armë zyrtare varësisht prej nevojave dhe vlerësimeve nga stafi menaxherial”, andaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka analizuar edhe kontratat e ankuesve dhe ka ardhur në konstatimin se të njëjtit marrëdhënien e punës e kanë të themeluar si Zyrtar Korrektues-Qendra e Paraburgimit Lipjan dhe jo si zyrtar për përcjelljen e të burgosurve apo paraburgosurve, madje ky fakt evidentohet edhe në nenin 3 të kontratave të tyre lidhur me vendin e punës ku specifikohet se: “I punësuar është njoftuar dhe pajtohet që, sipas nevojave operative të punëdhënësit mund të caktohet si masë jo disiplinore për periudhë të përkohshme ose të përhershme në vende të tjera pune për ushtrimin e funksioneve dhe detyrave të njëjta ose ndryshme,” shtuar faktin se edhe sipas shkresës së datës 03.03.2023 ku evidentohet hapja e aplikimit për të interesuarit që të jenë pjesë e Njësitit për Përcjelljen e të Burgosurve theksohet fakti se për të qenë pjesë e kësaj njësie zyrtarët korrektues nuk duhet të kenë masa aktive disiplinore, prandaj në vlerësimin e Kolegjit lirimi nga detyrat dhe përgjegjësit e ankuesve në kuadër të kësaj njësie është i arsyeshëm, ndërsa ankuesve nuk iu është cenuar në asnjë formë themelimi i marrëdhënies së punës sipas kontratave respektive të punës të referuara si në hyrje të arsyetimit të këtij vendimi përmes të cilave ankuesit vazhdojnë të jenë të punësuar në cilësi të Zyrtarit Korrektues-Qendra e Paraburgimit Lipjan në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, prandaj pretendimi ankimor i ankuesve është i pabazuar.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.318/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve, avokatit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së